



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

**THIRRJE PËR SHPREHJE INTERESI  
PËR VENDE TË LIRA PUNE  
PËR SEKRETARIATIN NË KUADËR TË VEPRIMTARISË SË MBAJTJES SË  
SEKRETARIATIT TË “BOLOGNA FOLLOW UP GROUP” NGA REPUBLIKA  
E SHQIPËRISË**

Bazuar në Vendimin nr. 1163, datë 24.12.2020 të Këshillit të Ministrave “Për ngritjen e Sekretariatit në kuadër të veprimtarisë së mbajtjes së Sekretariatit të “*Bologna Follow Up Group*” nga Republika e Shqipërisë”, Ministria e Arsimit dhe Sportit shpall thirrjen për vende të lira pune.

Ju mund të aplikoni duke dorëzuar dokumentet si më poshtë:

- Kërkesë me shkrim në të cilën të përcaktohet pozicioni për të cilin aplikoni;
- Jetëshkrim (CV) sipas formatit standard (Europass);
- Fotokopje të kartës së identitetit ose pasaportës;
- Kopje të noterizuar të diplomës/diplomave;
- Fotokopje të librezës së punës.

Dokumentet e kërkuara duhet të dorëzohen pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ose të dërgohen me postë në adresën: Rruga e Durrësit Nr. 23, AL 1001.

**Profilet e kërkuara dhe kriteret:**

Kjo thirrje për shprehje interesi, ka për qëllim dhënien e mundësisë për aplikim nga kandidatë që plotësojnë kriteret dhe shprehin interesin për veprimtarinë që do të zhvillojë Sekretariati i “Bologna Follow Up Group”. Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet mbi bazën e kualifikimeve të deklaruara në jetëshkrim ( Curriculum Vitae, CV) dhe në bazë të rezultateve nga intervista. Intervista njohëse do të synojë marrjen e informacionit mbi përvojën aktuale dhe profesionalizmin të cilat janë pasqyruar në CV, si dhe motivimin dhe vullnetin për të fituar pozicionin e punës. Në intervistë do të ftohen kandidatë për çdo pozicion.

Kriteret e përgjithshme:

Për secilin pozicion të kërkuar përmes kësaj thirrjeje janë përcaktuar si më poshtë kriteret e përgjithshme me qëllim vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve për:

- 1. Profili profesional: (1) Ekspert me kohë të plotë për hartimin e dokumenteve mbështetëse për BFUG-në, menaxhimin e proceseve teknike dhe institucionale dhe dhënien e rekomandimeve dhe asistencës në takimet e grupeve të punës.**

Eksperti me kohë të plotë dhe Eksperti i jashtëm me kohë të pjesëshme duhet të plotësojë kriteret si më poshtë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

- Të zotërojë diplomë të studimeve universitare brenda ose jashtë vendit, me notë mesatare të ponderuar 7 (shtatë) e lartë. Diploma e përfutur për studime jashtë Republikës së Shqipërisë duhet të jetë e njësuar sipas legjislacionit në fuqi.
- Të zotërojë me dëshmi gjuhën angleze me një nivel të paktën C1 (ose ekuivalente), ose të ketë realizuar një cikël studimi jashtë vendit në gjuhën angleze.
- Të ketë eksperiencë në projekte të huaja. Preferohet të jenë projekte të lidhura me Bashkimin Evropian ose Këshillin e Evropës.
- Të paraqesë të paktën 2 rekomandime nga punëdhënësit të mëparshëm dhe/ose profesorë gjatë studimeve universitare.

**2. Profili profesional: (3) Ekspertë të jashtëm me kohë të pjesshme në fushën e menaxhimit dhe të implementimit të projekteve, të cilët angazhohen në zhvillimin e aktiviteteve dhe takimeve të ndryshme të BFUG-së, bordit të BFUG-së, grupeve të punës dhe grupeve këshilluese të BFUG-së, si edhe në organizimin e Konferencës Ministrore të ZEAL-së në vitin 2024.**

Eksperti i jashtëm me kohë të pjesshme duhet të plotësojë kriteret si më poshtë:

- Të zotërojë diplomë të studimeve universitare brenda ose jashtë vendit, me notë mesatare të ponderuar 7 (shtatë) e lartë. Diploma e përfutur për studime jashtë Republikës së Shqipërisë duhet të jetë e njësuar sipas legjislacionit në fuqi.
- Të zotërojë me dëshmi gjuhën angleze me një nivel të paktën C1 (ose ekuivalente), ose të ketë realizuar një cikël studimi jashtë vendit në gjuhën angleze.
- Të ketë eksperiencë në projekte të huaja. Preferohet të jenë projekte të lidhura me Bashkimin Evropian ose Këshillin e Evropës.
- Të paraqesë të paktën 2 rekomandime nga punëdhënësit të mëparshëm dhe/ose profesorë gjatë studimeve universitare.

**3. Profili profesional: (1) Ekspert me kohë të plotë në fushën e medias dhe komunikacionit i cili do të ndihmojë në zbatimin e strategjisë dhe instrumenteve të mediave sociale.**

Eksperti duhet të plotësojë kriteret si më poshtë:

- Të zotërojë diplomë të studimeve universitare brenda ose jashtë vendit, me notë mesatare të ponderuar 7 (shtatë) e lartë. Diploma e përfutur për studime jashtë Republikës së Shqipërisë duhet të jetë e njësuar sipas legjislacionit në fuqi.
- Të zotërojë me dëshmi gjuhën angleze me një nivel të paktën C1 (ose ekuivalente), ose të ketë realizuar një cikël studimi jashtë vendit në gjuhën angleze.
- Të ketë eksperiencë në projekte të huaja. Preferohet të jenë projekte të lidhura me Bashkimin Evropian ose Këshillin e Evropës.
- Të paraqesë të paktën 2 rekomandime nga punëdhënësit të mëparshëm dhe/ose profesorë gjatë studimeve universitare.



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Të gjithë kandidatët duhet të jenë rezident në Shqipëri.

Për të gjitha kriteret e kërkuara në këtë njoftim, sigurohet një qasje e barabartë, duke respektuar barazinë gjinore, fetare, ideore, kulturore dhe çdo karakteristikë tjetër personale. Në këtë thirrje do të promovohet transparenca dhe etika në kryerjen e aktiviteteve nga profesionistët dhe ekspertët, të cilët duhet të respektojnë Kodin e Etikës dhe legjislacionin në fuqi.